



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Njoftim Publik

Në Drejtorinë e Urbanizmit të Komunës së Prishtinës është dorëzuar aplikacioni 05 nr.350/02 – 49879/25 dt.10.04.2024, përmes aplikimit E – Leja, në emër të Pronarëve: Sabri Bekteshi, Bahtijar Bytyqi, Fahredin Qyqalla nga Prishtina dhe Investitorëve: "Euro Fenix"sh.p.k. nga Prishtina me certifikatë të biznesit ARBK 810076613, me përfaqësues Mirushe Kuçi dhe "Diamond Group"L.L.C. nga Prishtina me certifikatë të biznesit ARBK nr.810838732, me përfaqësues Jeton Selimi, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimore / projektin kryesor për ndërtimin e ndërtesave shumë banesore & afariste – **Ndërtesa: "1"** me 2B+S+P+4+Ph, **"2"** me 2B+S+P+5+Ph(Faza "1" – me Investitor "Euro Fenix"sh.p.k. nga Prishtina) & **"3"** me 2B+S+P+4+Ph(Faza "2" me Investitor "Diamond Group"L.L.C. nga Prishtina) në kuadër të Bllokut urban "A-10", Tërësia "I" të Planit Rregullues "Mati 1" në Prishtinë, konkretisht parcelave: nr.762-9, 762-10, 762-11, 762-12, 762-14, 762-15, 762-16, 762-17, 762-21 dhe 1555-0 ZK Matëçan, sipas projekt propozimit / Planit të situacionit - "zgjidhjes urbane" të prezantuar.

Me aplikacion është prezantuar edhe projekt propozimi për ndërtimin e kompleksit të lartcekur. Bazuar në pikën 2 të nenit 18 të Ligjit për ndërtim nr.04/L-110 dt.31.05.2012, "Organi kompetent njofton publikun dhe mundëson komentet për kërkesën e dhënies së lejes së ndërtimit". Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data **17.04.2025** deri me datën **30.04.2025** në Email adresën: **urbanizmprihtine@rks-gov.net**

Kushtet e propozuara: Ndërtesat shumë banesore & afariste – Ndërtesa: "1" me 2B+S+P+4+Ph, "2" me 2B+S+P+5+Ph & "3" me 2B+S+P+4+Ph	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Tokë bujqësor -"Arë e Klasës 5" / Tokë ndërtimore
b. Vija rregulluese	0.00 m' Sipas Planit rregullues "Mati 1"
c. Vija ndërtimore	3.0 m' Sipas Planit rregullues "Mati 1"
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	8.8m'/22m'
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësorë dhe të pasmë të parcelës kadastrale.	Anësor: 8.2/18m' & 3.0m'/18m' Pasmë : 8.2m'/18m' & 3.0m'/18m'
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHP)	ISHP=40%-S=1,254.80 m ² , lejuar -S=1,153.68m ² , projektuar
g. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese mbi tokë në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISPN)	2.4- S=7,528.80m ² , të lejuara - S=7,518.52m ² , projektuar
h. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHGJ)	40%- S=1,254.80 m ² , lejuar - S=1,255m ² , projektuar
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHN)	60% ose S=1,882.20m ² , lejuar & S=1,794.60m ² - projektuar
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve	108 VP, nën tokë
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	Po
l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po - ☒ Jo - ☐ Nuk aplikohet - ☐	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe sesa zona përreth? Po - ☐ Jo - ☒ Nuk aplikohet - ☐ Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në zona të mbrojtura, zona të veçanta ose zona të veçanta të mbrojtura? Po - ☐ Jo - ☒ Nuk aplikohet - ☐ Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit administrativ 06/2017, dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrërimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës.

Në të gjitha komentet tuaja duhet të përshtatet numri i kërkesës të shënuar më lartë.

Nënshkrimi i Zyrtarit: _____